

Levizjet/ Partizani nuk heq dore nga Mentor Zhdrella

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 09 Dhjetor 2013 15:36



Partizani ka nje skuader solide, te mireorganizuar e me shume lojtare cilesore por nuk ka fantazine qe i duhet trajnerit Lika. Per kete arsye, Mentor Zhdrella, nje nga me te miret e Superliges kosovare eshte ne planet e te kuqve. Bisedimet me te kane nisur prej disa kohesh por akoma nuk eshte arritur gjuha e perbashket. Zhdrella ka pretendime te larta financiare dhe Partizani eshte gati te bej nje sforco per ta arritur kete futbollist. Skuadra nga kryeqyteti shikon se mund te garoj per titullin kampion ndaj edhe do provoj te perforcohet ne muajin janar.